



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 189/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjore Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS) dega në Leposaviq, paraqitur kundër subjektit politik G.I Sërpska Lista, dega në Leposaviq, për shkak të pengimit të mbajtjes së fushatës zgjedhore dhe kërcënimeve, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS) dega në Leposaviq e datës 09.06.2017.

### A r s y e t i m

Me datën 09.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partija Kosovski Serba (PKS) dega në Leposaviq, në të cilin thekson se të gjitha subjektet politike kanë të drejta të barabarta gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore në formën e mitingjeve, të vendosjes së posterave, të lobimit për organizatën e caktuar politike. Kjo e drejte sipas parashtruesit të ankesës i mohohet subjektit politik PKS nga ana e G.I Srpska Listës, ku aktivistet e tyre përveç se çdo poster të subjektit politik PKS e shqyejnë, ata edhe i kërcënojnë aktivistet tanë, ju grabisin posteret dhe i provokojnë. Sipas parashtruesit të ankesës G.I Srpska Lista për çdo ditë zhvillon një fushatë të pistë sepse i kërcënon njerëzit me pushim nga puna nëse votën e tyre nuk i ja japin G.I Srpska Listës edhe në qoftë se detyrohen të votojnë publikisht. Me datën 05.06.2017 gjatë mbajtjes së konferencës për shtyp të cilën e ka thirr kryetari i subjektit politik PKS Aleksandër Jabllanoviq, aktivistet e G.I Srpska Listes e kane rrahur brutalisht aktivistin tonë njëkohësisht vozitësi i Aleksandër Jabllanoviqit dhe e gjitha kjo në prani të Sllavko Simiqit i cili vet i solli këta aktivist dhe kjo në praninë e Zoran Tadiqit dhe në prani të policisë e cila ka qëndruar në afërsi të vendit të ngjarjes.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar:**

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se aktivistet e subjektit politik G.I Srpska Lista i kane mohuar mbajtjen e tubimeve, shqyerje e posterave si dhe kërcënime të ndryshme dhe rrahje ndaj përfaqësuesve te subjektit politik PKS ne qytetin e Leposaviqit ku me këto veprime është shkaktuar tension në procesin zgjedhor.

Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar ngase parashtruesi i ankesës, pretendimeve ankimore nuk i ka mbështetur asnjë provë materiale, e cila do ti vërtetonte pretendimet e tij, andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 189/2017 më datën 10.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.